



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ___/ ___/ 2021

VENDIM

Nr.18, date 31 /03/2021

PËR

**MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT GJATE REHABILITIMIT TE
DIGAVE JANJAR, MURSI, PASKUQAN, SHTODER, SPITALLE SI DHE
PUNIMEVE TE NDERTIMIT PER MBROJTJEN E ZONES TEK KULLAT
E EKUILIBRIT TE DIGES SE HEC KOMANIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 20, si dhe duke u bazuar në kontrollet dhe informacionet në terren të këtyre punimeve, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 31.03.2021

VENDOSI:

- 1- Ti kërkojë shfrytëzuesve të Digave të mesiperme që po kryejnë punime ndertimi për rehabilitimin e digave të përmendura më sipër si dhe punimet për mbrojtjen e zonës së kullave të ekuilibrit në digën e HEC Koman:
 - Plotesimin e kërkesave të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", neni 19, neni 20 dhe 24
 - Miratimin në KKDM të mbikqyresit të punimeve dhe stafit të tij të pajisur me licence profesionale dhe të emeruar nga Pronari apo shfrytëzuesi i digës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në përputhje me këtë Vendim dhe legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI